




**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO**



**KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE**

24/06/2024

Nr. i Protokollit: 02/678

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Pjetërshticë

E enjte, më 13 qershor 2024

Kohëzgjatja e takimit: 19:45 – 21:00

Vendi i takimit: SHF "Idriz Ajeti"

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i Shërbimeve Publike – Bardhyl Rushiti, Asambleisti – Besnik Seferi.

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027

Kryesuesi i Kuvendit, Adnan Ademi : Përshëndetje për të gjithë dhe faleminderit që sot ju keni përgjigjë ftesës që të jeni në këtë takim. Ky takim ka të bëjë me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2025-2027, ne jemi ardhë në fshatin Pjetërshticë që të marrim kërkesat e banorëve, të cilat ata i shohin si prioritete. Ato kërkesa të cilat i keni bërë në vitin 2023 për këtë vit tani më janë në procedura e sipër dhe brenda këti viti përfundojnë, ndërsa disa të tjera tani më janë përfunduar. Fat i mirë është që në Komunën e Shtimes buxheti është rritur për afro 1 milion euro këtë vit dhe fat i mirë është që me këtë buxhet janë rritur dhe investimet të cilat do të bëhen në të gjitha fshatrat e Shtimes.

Pjesa e parë e këtij buxheti shkon në paga dhe mëditje, do të thotë buxheti është rritur për shkak se janë rrit edhe pagat nga niveli qendror, pjesa tjetër e buxhetit janë mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencionet i kemi rritur nga 350 mij, për vitin 2025 parashihet të jenë 500 mij që i bie që gjys milionit janë vetëm për subvencione. Ndërsa tek investimet kapitale kemi një rritje prej 400 mij euro të cilat do të bëhen për vitin 2025.

Sa i përket investimeve në Komunën tonë kemi edhe investimet Qeveritare, tash më lejoni t'i numroj disa nga këto projekte : është bërë Tranziti ku vlera është 1 milion e 700 mij, kemi unazën me 1 milion e 500 mij, rruga për tek kulla e lirisë me vlerë 470 mij, është bërë Shtabi i Rancës i cili e ka një vlerë të jashtëzakonshme përveç anës financiare është Shtab në të cilin ka qëndruar Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Kulla po ashtu është bërë edhe në Mollopolc ku ka qenë spitali, është funksionalizuar njëra Çerdhe dhe tjetra pritjet të finalizohet në fshatin Muzeqinë, po ashtu tjetra është në përfundim punimet e vrazhda kanë përfunduar në fshatin Godanc dhe në fshatin Petrovë fillon këtë vit, gjithashtu fillon edhe aneksi i shkollës në Petrovë, janë bërë disa renovime të shkollave aty ku ka pasur nevojë. Këto janë në vija të trasha disa nga investimet, pa i përmendur rrugët, rrugicat, kanalizimet edhe ndriçimet të cilat janë bërë. Ne si qeverisje kemi përfituar grantin e performancës prej 400 mij euro, si qeverisje e mire, do të thotë radhitemi ndër pesë komunat me

qeverisje më transparente në Kosovë dhe kësisoj i kemi sjellë edhe 400 mij euro shtesë buxhetit të komunës së Shtimes. Me këta hapa po mundohemi të vazhdojmë edhe tutje. Arsyeja pse ne sot jemi këtu është që të marrim kërkesa specifike prej secilit vendbanim që ka të bëjë me Komunën e Shtimes edhe ato kërkesa të qytetarëve t'i vendosim në buxhet.

Kërkesat e banorëve të fshatit :

- Berat Gashi: Salla e sportit nëse ka mundësi të bëni një shtytje që nxënësit të kenë ku të luajnë. Drenazhën e disa arave, gjithashtu gjatë rrugës 'Lluga', të bëhen edhe kanalet e ujitjeve.

Rehabilitimi i rrugës 'Idriz Ajeti', po ashtu është problem kanalizmi në këtë rrugë.

Rrugë e arave të shtrohet: rruga e 'Pejës; dhe rruga ' Aziz Dugolli'.

Një shesh të bëhet në shfatin Pjetershticë tek shkronjat e UÇK-së.

Të rregullohet çeshmja tek shkolla, ti bëhet një mbulojë e të ketë një pamje më të mirë.


Mirëmbajtja e varrezave në fshatin Pjetërshticë dhe në rrugën 'Idriz Ajeti', rehabilitim i trotuarit.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti







REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në Pjetërshticë

Date: 13/06/2024

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	Agim Gashi	
2	Behram Gashi	
3	Muhamet Qeriqi	
4		
5		
6		
7		
8		
9		
10		
11		
12		
13		
14		
15		
16		
17		